



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 2004 Prot.

Tiranë, më 22.02 2018

URDHËR

NR. 86, DATË 22.02.2018

PËR

MIRATIMIN E STATUTIT TË ORGANIZATËS KOMBËTARE ANTIDOPING

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 44/1 të Ligjit 79/2017 « Për Sportin », nenit 3/2 të Ligjit nr.9242, datë 17.06.2004 “Për ratifikimin e “Konventës Europiane antidoping, 1989” dhe nenit 7 të Ligjit nr. 9623, datë 16.10.2006 « Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare kundër dopingut në sport, 2005 »,

URDHËROJ

1. Miratimin e Statutit të Organizatës Kombëtare Antidoping, sipas tekstit bashkëlidhur, Vendimi i Asamblesë Zgjedhore të Organizatës Kombëtare Antidoping, datë 07.12.2017.
2. Ngarkohet Organizata Kombëtare Antidoping për regjistrimin e statutit të saj në Gjykatën kompetente.
3. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Organizata Kombëtare Antidoping.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Lindita Nikolla

